BASHKIA KORCE
NR 8167 PROT
DATA 08/10/2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE MENAXHIMIT TË KONTRATAVE**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCAVE , BUXHETIT DHE MFK**
**QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS**

# RELACION

## PËR NJË SHTESË NË VKB NR 34, DATË 29.02.2024

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontatave, duke u bazuar në Ligjin nr 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin 68/2017 'Për financat e qeverisjes vendore"; Ligjin 97/2023 datë 07.12.2023 "Për buxhetin e vitit 2024"; Udhezimin Nr 83 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të projekt buxhetit afatmesëm" , i ndryshuar; Ligji nr 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; VKB Nr 127 datë 26.09.2024 mbi miratimin e PBA 2025-2027 Faza II si dhe VKM nr 70, datë 14.02.2024 , për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 887, Datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "PËR PROCEDURAT E MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE PUBLIKE", propozon qe në listën e prioriteteve të investimeve për vitin 2024-2026, të aprovuara më VKB nr 34 , datë 29.02.2024, të shtohen dhe tre invetimet e mëposhtme:

1. **Investime për Qëndren e Artit Kulturës dhe Inovacionit Korçë**, me vlerë totale 10.000.000 lekë.

Projekti ka si qëllim përmirësimin e kushteve të Qëndrës së Artit Kulturës dhe Inovacionit, duke krijuar një hapësire aktive, të hapura që shkojnë paralelisht me artin bashkëkohor dhe shoqërinë. Investimi në infrastrukurë (pajisjet e kondicionereve) dhe instrumenta do të cojë në ruajtjen e formcioneve ekzistuese dhe krijimin e formacioneve të reja me artistë të rinj që do të vazhdojnë traditën artistike për të evoluar artin në të ardhmen, krijimin e të mirave dhe produkteve kulturore, krijimin e kulturës si mjet për zhvillimin ekonomik, mbështetjen dhe fuqizimi i të rinjve, ofrimin e cilësisë së lartë kulturore dhe artistike si dhe shërbimin inovativ si dhe promovimin e vlerës së veprimtarisë kulturore në zhvillimin e përditshëm dhe ngritjen e cilësisë së jetës

2. **Rikonstruksioni i Muzeut Oriental "Bratko", me vlerë totale 6.000.000 leke.**

Qëllimi i këtij projekti është rikonstruksioni pjesor i këtij muzeu , duke e transformuar atë dhe koleksionin e tij në një qendër tërheqëse social-kulturore në qytetin e Korçës, e cila do të ofrojë hapësira moderne dhe të sigurta për ekspozimin e veprave artistike dhe artefakteve historike, duke respektuar standardet bashkëkohore të arkitekturës dhe dizajnit, duke promovuar vlerat historike dhe kulturore të trashëguara, Kjo qëndër do të nxitë ndërveprimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit dhe vizitorëve përmes aktiviteteve edukative dhe kulturore, duke transformuar muzeun në një urë lidhëse

midis së kaluarës dhe së ardhmes, si dhe duke theksuar rëndësinë e kontributit filantropik të individëve si George Dh. Mborja, duke inkurajuar mbështetjen dhe angazhimin për artin dhe kulturën. Në thelb, projekti synon të krijojë një ambient të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe frymëzues që kontribuon në zhvillimin kulturor dhe artistik të qytetit të Korçës dhe më gjerë.

3. **Laboratori i Industritive Kreative dhe muzealizimi inovativ i qendrës turistike, Voskopojë, me vlerë totale 20.000.000 lekë.**

Qëllimi i këtij projekti ështe krijimi i një mjedisi inovativ dhe bashkëpunues që nxit zhvillimin profesional dhe krijimtarinë në industritë kreative dhe Inteligjencës Artificiale, duke ofruar burime, teknologji dhe mbështetjepër individët dhe bizneset, me qëllim realizimin e potencialit të tyre duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të komunitetit si dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike përmes teknologjive të avancuara.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT**
**TË TERRITORIT DHE MENAXHIMIT**
**TË KONTRATAVE**

**Drejtor i deleguar**

**Ndricim Hoxha**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E**
**FINANCES BUXHETIT DHE MFK**

**Valbona ZIKO**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME**
**JURIDIKE DHE TË MENAXHIMIT TË**
**BURIMEVE NJERËZORE**

**Anxhela QERAMIXHI (DISHNICA)**

**QËNDRA E ARTIT DHE KULTURËS**

**Zamira Kita**

**Në mungesë dhe me urdhër**

**Drejtore e Bibliotekës**

**Jorida Tollkuçi**

**KRYETARI I BASHKISE**

**SOTIRAQ FILO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**
**KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT**

**KORÇË**

**P/VENDIM**

**Nr. Datë**

**PËR**

**PËR NJË SHTESË NË VKB NR 34, DATË 29.02.2024**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi morri në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontatave, duke u bazuar në Ligjin nr 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin 68/2017 'Për financat e qeverisjes vendore"; Ligjin 97/2023 datë 07.12.2023 "Për buxhetin e vitit 2024"; Udhezimin Nr 83 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të projekt buxhetit afatmesëm" , i ndryshuar; Ligji nr 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; VKB Nr 127 datë 26.09.2024 mbi miratimin e PBA 2025-2027 Faza II si dhe VKM nr 70, datë 14.02.2024 , për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 887, Datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "PËR PROCEDURAT E MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE PUBLIKE", propozon qe në listën e prioriteteve të investimeve për vitin 2024-2026, të aprovuara më VKB nr 34 , datë 29.02.2024 mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve:

**VENDOSI**

1. Të shtoje listën e prioriteteve të investimeve si më poshtë:

- **Investime për Qëndren e Artit Kulturës dhe Inovacionit Korçë**, me vlerë totale 10.000.000 lekë.

Projekti ka si qëllim përmirësimin e kushteve të Qëndrës së Artit Kulturës dhe Inovacionit, duke krijuar një hapësire aktive, të hapura që shkojnë paralelisht me artin bashkëkohor dhe shoqërinë. Investimi në infrastrukurë (pajisjet e kondicionereve) dhe instrumenta do të cojë në ruajtjen e formcioneve ekzistuese dhe krijimin e formacioneve të reja me artistë të rinj që do të vazhdojnë traditën artistike për të evoluar artin në të ardhmen, krijimin e të mirave dhe produkteve kulturore, krijimin e kulturës si mjet për zhvillimin ekonomik, mbështetjen dhe fuqizimi i të rinjve, ofrimin e cilësisë së lartë kulturore dhe artistike si dhe shërbimin inovativ si dhe promovimin e vlerës së veprimtarisë kulturore në zhvillimin e përditshëm dhe ngritjen e cilësisë së jetës

- **Rikonstruksioni i Muzeut Oriental "Bratko", me vlerë totale 6.000.000 leke.**

Qëllimi i këtij projekti është rikonstruksioni pjesor i këtij muzeu , duke e transformuar atë dhe koleksionin e tij në një qendër tërheqëse social-kulturore në qytetin e Korçës, e cila do të ofrojë hapësira moderne dhe të sigurta për ekspozimin e veprave artistike dhe artefakteve historike, duke respektuar standardet bashkëkohore të arkitekturës dhe dizajnit, duke promovuar vlerat historike dhe kulturore të trashëguara, Kjo qëndër do të nxitë ndërveprimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit dhe vizitorëve përmes aktiviteteve edukative dhe kulturore, duke transformuar muzeun në një urë lidhëse midis së kaluarës dhe së ardhmes, si dhe duke theksuar rëndësinë e kontributit filantropik të individëve si George Dh. Mborja, duke inkurajuar mbështetjen dhe angazhimin për artin dhe kulturën. Në thelb, projekti synon të krijojë një ambient të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe frymëzues që kontribuon në zhvillimin kulturor dhe artistik të qytetit të Korçës dhe më gjerë.

- **Laboratori i Industritive Kreative dhe muzealizimi inovativ i qendrës turistike, Voskopojë, me vlerë totale 20.000.000 lekë.**

Qëllimi i këtij projekti ështe krijimi i një mjedisi inovativ dhe bashkëpunues që nxit zhvillimin profesional dhe krijimtarinë në industritë kreative dhe Inteligjencës Artificiale, duke ofruar burime, teknologji dhe mbështetjepër individët dhe bizneset, me qëllim realizimin e potencialit të tyre duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të komunitetit si dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike përmes teknologjive të avancuara.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithsme e Planifikimi të territorit dhe menaxhimit të kontratave, Drejtoria e përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK si dhe Qëndra e Artit dhe Kulturës

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Ana Verushi**